



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË LIRË TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTET

LËNDA: TEATËR

KODI: 1.5.11.Z

PROGRAMI I MODULIT “SHFAQJE TEATRALE”

PËR KLASËN E 11^{të}

TIRANË, DHJETOR 2009

Moduli “Shfaqje teatrale” pajis nxënës/in,-en me disa shprehje elementare të mjeshtërisë aktoreske dhe skenike, si edhe i ndihmon ata në pasurimin e botës shpirtërore me ndjenja të tilla që kanë të bëjnë me njohjen e vetvetes dhe me të qenit i/e hapur ndaj të tjerëve, me lirshmërinë në komunikim, në shprehjen saktë dhe bukur të gjuhës amtare, me koncepte që do ta ndihmojnë atë të vlerësojë teatrin si një nga mjetet efikase në procesin e gjatë të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Realizimi i këtyre bëhet i mundur me pjesëmarrjen, angazhimin dhe realizimin e një shfaqjeje të plotë artistike teatrale, ku roli i secilit nxënës gjendet dhe krijohet në bazë të aftësive dhe prirjeve individuale.

1. SYNIMI I MODULIT

Programi i modulit "Shfaqje teatrale" synon që nxënësit të fitojnë shprehje, sidomos nxënësit me prirje për aktor apo prirje për çdo lloj spektakli artistik, si dhe ata që duan ta bëjnë teatrin karrierën e tyre të ardhshme. Nxënësit që do të zgjedhin këtë lëndë, mund të bëhen pjesë e shfaqjes edhe duke mos marrë përsipër realizimin e një roli, por aspekte të tjera të realizimit të shfaqjes, si: *regjia, menaxhimi, marketingu* etj.

Moduli i shërben çdo nxënësi tjetër që synon të përfitojë aftësi për jetën nëpërmjet teatrit.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij moduli, nxënës/i,-ja duhet të jetë i/e aftë:

- të kuptojë hapat se si realizohet një shfaqje artistike, duke përcaktuar vendin e pjesëmarrësve në një shfaqje teatrale;
- të analizojë një pjesë teatrale, në tërësi dhe rolin e tij/saj individual në veçanti;
- të realizojë, nëpërmjet pjesëmarrjes praktike, etapat në të cilat kalon procesi i realizimit të një shfaqjeje duke filluar nga *zgjedhja e pjesës* deri tek *premiere e saj*;
- të demonstrojë teknikat elementare dhe thelbësore që kanë të bëjnë me krijimin aktoresk;
- të vlerësojë rrugën nëpërmjet krijimit të *rolit*, si dhe rrugën nëpër të cilën kalon arti i aktorit duke realizuar figurën artistike të personazhit (karakterit) të veprës dramatike;
- të demonstrojë qëndrime etiko-sociale gjatë punës në grup dhe si individ.

Përshkrimi i modulit: Përmbajtja e këtij moduli ka karakter praktik. Të mësuarit mbi të dhe nëpërmjet saj do të realizohet duke marrë pjesë dhe duke realizuar një shfaqje teatrale. Gjatë procesit të realizimit të shfaqjes, nxënësit detyrimisht, do të pajisen nën drejtimin e mësuesit-regjisor ose udhëheqësit artistik me literaturën përkatëse në shërbim të shfaqjes dhe realizimit të rolit individual. Gjithashtu, nën drejtimin e mësuesit-regjisor ose udhëheqësit artistik ata do të përvetësojnë koncepte, shprehi, taktika dhe strategji, që do të bëjnë të mundur realizimin me sukses të shfaqjes, gjë që çon në arritjen e e objektivave të mëposhtëm, të gjitha këto.

Orë të sugjeruara: 36 orë

Bloku tematik	Objektiva
<p>Zgjedhja e pjesës</p> <p>Ndarja e roleve</p>	<p>Në përfundim të modulit, nxënës/i,-ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë etapat nëpër të cilën kalon realizimi i shfaqjes: <ul style="list-style-type: none"> - zgjedhja e pjesës, - ndarja e roleve, - njohja me autorin, stilin, individualitetin e tij dhe njohja me epokën kur është shkruar pjesa, - gjetja e qëllimi pse e ka shkruar autori pjesën, - analiza: gjetja e temës, idesë dhe mesazhit që do të përcjellë shfaqja; zberthimi i konflikteve, analiza e personazheve; zberthimi i ngjarjeve, fakteve, i rrethanave, qëllimit, i motiveve, i veprimeve dhe i marrëdhënieve të personazheve.
<p>Analiza e dramës dhe elementet e saj</p> <p>Provat</p> <p>Provat në tavolinë</p> <p>Provat në lëvizje</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë pjesët e dramës së përzgjedhur dhe elementet e saj: <ul style="list-style-type: none"> - zberthimi i konflikteve dhe gjithë aspekteve të tjera strukturore të dramës që do të ndihmojë në kompozimin e shfaqjes së ardhshme, - analiza e personazheve, - zberthimi i ngjarjeve, fakteve, i rrethanave, i qëllimit, i motiveve, i veprimeve dhe i marrëdhënieve të personazheve, • të realizojë provat duke punuar në grup dhe individualisht, si: <ul style="list-style-type: none"> - provat në tavolinë, - provat në lëvizje, - provat me kostume, - provat e lidhura, - prova gjenerale, - premiera; • të demonstrojë aftësi interpretuese dhe të bashkëpunojë gjatë provave.

<p>Veprimi, mjete kryesor i aktorit për realizimin e qëllimit.</p> <p>Figura artistike dhe elementet e saj ndihmëse.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të demonstrojë gatishmëri, disiplinë, frymë demokratike, bashkëpunim dhe respekt reciprok, për realizimin e shfaqjes; • të zhvillojë aftësi për të qenë pjesë e punës në ekip, duke kontribuar në krijimin e një atmosfere me frymëzim të lartë artistik dhe duke dhënë më të mirën e mundshme; • të realizojë me cilësi të lartë artistike rolin që i është besuar, nëpërmjet teknikave më elementare të aktrimit të tilla si: <ul style="list-style-type: none"> - veprimi, përshtatja, të shikuarit, të dëgjuarit, etj., - vlerësimi i ngjarjeve, i fakteve, i rrethanave, monologu i brendshëm, marrëdhënia me partnerin etj.; • të fitojë shprehi në lidhje me aspekte të tjera të realizimit të shfaqjes teatrale si: menaxhimi, publiciteti, marketingu, posterat, reklamat etj.; • të vlerësojë rëndësinë që ka aktiviteti teatror në marrëdhënie me publikun dhe vlerat që ai mbart si një nga aktivitetet kulturore më të rëndësishme.
--	---

4. KËRKESA PËR ZBATIMIN E MODULIT

Moduli "Shfaqje teatrale", realizohet në 36 orë mësimore vjetore. Ky modul është një dokument zyrtar i cili është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës. Në mënyrë që programi i këtij moduli të zbatohet sa më mirë, përdoruesit e tij duhet të njohin thellë programin lëndor të lëndës "Teatër" (kurrikula bërthamë).

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Të gjitha kërkesat e programit duhet të jenë të lidhura me realizimin final të shfaqjes. Moduli zgjat 36 orë të cilat duhet të ndahen sipas specifikave që ka realizimi i një shfaqjeje teatri.

Bloqet kryesore nëpër të cilat kalon ky proces janë:

1. **Zgjedhja e pjesës.** Kjo fazë kërkon 2 deri në 3 orë. Kjo është koha kur nxënësit vihen në lëvizje, lexojnë drama, konsultohen me njëri-tjetrin, më specialistë të teatrit, aktorë, regjisorë, etj. Mësues/i,-ja udhëheq gjatë gjithë kohës në rolin e regjisorit. Gjithashtu, ai së bashku me nxënësit konsultohen dhe diskutojnë në seancat e planifikuara mësimore. Nëse regjisorë mund të jetë një ose dy nxënës, mësues/i,-ja luan rolin e udhëheqësit artistik.
2. **Faza e njohjes dhe e studimit të tekstit.** Edhe kjo mund të zgjasë 2 deri në 3 javë dhe seancat mësimore mund të kryhen në mënyrë formale, në klasë, me mësuesin-udhëheqës artistik, një herë në javë.
3. **Ndarja e roleve, analiza dhe provat e tavolinës.** Është një seancë e veçantë mësimore dhe duhet të jetë një moment i rëndësishëm. Pas ndarjes së roleve, fillon periudha e analizës së bashku me provat në tavolinë. Edhe periudha e tavolinës mund të jetë me një farë shtrirjeje, por më e shkurtër se fazat e para. Mundet që orët të grupohen deri në tri herë në javë, ndaj ky proces mund të zgjasë dy deri në tri javë.

4. Periudha e lëvizjes në skenë ose, siç quhet ndryshe, *mizanskenimi*. Realizimi i mizanskenës është një periudhë më intensive. Ajo zgjat 4 deri 5 seanca në javë që duhet të zgjasin 10 ditë apo, e thënë ndryshe, deri në dy javë. Gjatë kësaj kohe punohet edhe me kostumet, me skenografinë apo edhe me elemente të tjera.
5. Periudha e fundit, periudha e provave të lidhura dhe e *premierës*. Kjo periudhë kërkon që nxënësit me në krye mësues/in,-en të bëjnë prova çdo ditë, ose edhe dy herë në ditë. Ndoshta njëra nga seancat ditore mund të jetë punë e pavarur e nxënësve. Ky proces zgjat 5 ditë deri në 7 ditë dhe ditën e shtatë mund të jepet premiera.
Natyrisht, për këtë ndarje nuk ka receta të prera, por logjike është që shfaqja teatrale të realizohet brenda një semestri kur një periudhë deri në dy javore duhet të jetë intensive dhe kur kërkohet grupimi i orëve, një skemë e përgjithshme e së cilës u rendit më sipër. Duke qenë një lëndë artistike me zgjedhje, moduli “Shfaqje teatrale” duhet të mbështetet fuqishëm edhe tek puna e pavarur e nxënësve dhe pasioni i tyre, sidomos në periudhën e finalizimit të shfaqjes.

Si mjedis më i përshtatshëm për finalizimin e këtij moduli, do të shërbente një klasë e posaçme për aktivitetet artistik, nëse shkolla e zotëron një mjedis të tillë. Në mungesë të një mjedisi të tillë, më i përshtatshëm do të ishte improvizimi i një skene që mund të bëhet edhe në palestrën e shkollës. Por akoma më mirë do të ishte që, javën e punës për daljen e premierës, të kërkohet një skenë në institucionet artistike të rajonit ku ndodhen nxënësit dhe një mbështetje nga ky institucion edhe për bazën materiale të shfaqjes: kostume, skenografi, objekte etj. Dita e premierës duhet të kthehet në një ceremoni të veçantë për gjithë shkollën dhe komunitetin.

Objektivat

Objektivat e modulit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit të modulit “Shfaqje teatrale”. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të performojnë sipas rolit që kanë, atë çka përshkruhet tek objektivat. Pjesa dramatike që do të zgjidhet për të realizuar programin e modulit, duhet të mbulojë me role të gjithë nxënësit e interesuar. Natyrisht, etika e profesionit të aktrimit e kërkon që të mos bëhet dallim midis rolit të madh dhe të vogël dhe rolet të ndahen sipas përshtatshmërisë dhe mundësive, por të gjithë nxënësit e interesuar duhet të kenë role.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësues/i,-ja duhet të mbulojë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve. Kështu p.sh.: objektivi: “*Të demonstrojë gatishmërinë për të qenë pjesë e shfaqjes, me detyrë kryesore realizimin me cilësi sa më të lartë të rolit, nëpërmjet teknikave më elementare të aktrimit*” kërkon nga të gjithë nxënësit të demonstrojnë aftësi në realizimin apo ekzekutimin e elementeve teknike aktoriale, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel performance.

Orët mësimore

Për modulën “Shfaqje teatrale” përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetorë të lëndës. Mësues/i,-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit, hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e modulit të shfaqjes teatrale, afërsisht **35%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **65%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

5. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e modulit dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në programin e modulit.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si për shembull:

- përdoren fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit, bëhet korrigjimi me shumë takt i gabimeve në interpretim ose në një artikulum të fjalisë ose batutës së personazhit;
- vlerëson një nxënës/e duke i besuar rolin kryesor, edhe pse ky vlerësim e obligon më shumë nxënës/in,-en dhe i jep më shumë përgjegjësi;
- shpall interpretuesin më të mirë;
- ngarkon detyra më të vështira për realizim;
- vlerëson pjesëmarrjen dhe aktivizimin në veprimtaritë e ndryshme artistiko-kulturore.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësues/i,-ja duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive dhe aftësive të fituara të orëve të kaluara.

Vlerësimi për këtë modul duhet të bazohet kryesisht në nivelin e angazhimit, përkushtimit, nivelin e arritjeve personale, shfaqjes së shpirtit të kolektivitetit dhe përgjegjshmërisë, respektit ndaj punës dhe partnerit. Realizimi i shfaqjes përbën një sfidë për të gjithë pjesëmarrësit dhe kush i reziston më mirë kësaj sfide, ai/ajo duhet të jetë më i vlerësuar. Por, pa dyshim që edhe niveli artistik do të merret në konsideratë.